



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 444/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbesa Gashi kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Fushë Kosovë, paraqitur për shkak të mungesës së votave në vendvotimin 0901E/07R, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 444/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Arbesa Gashi kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Fushë Kosovë, paraqitur për shkak të mungesës së votave në vendvotimin 0901E/07R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Arbesa Gashi kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Fushë Kosovë në të cilën pretendon se e njëjta ka votuar në shkollën Selman Riza më saktësisht në vendvotimin 0901E/07R por se pas pranimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e komisionarëve dhe vëzhguesve nuk ka pasur asnjë votë. Parashtruesja e ankesës thekson se në këtë vendvotim kanë votuar edhe familjaret e saj. E njëjta kërkon që të behet rinumërimi i votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë për vendvotimin 0901E/07R në Fushë Kosovë për faktin se shkeljet që

ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Arbesa Gashi, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr. 444/2017 më datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Zyhë Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.